

VENDIM
Nr. 34, datë 31.1.2013

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 248, DATË 27.4.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË
INFORMACIONIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 11 të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 248, datë 27.4.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

a) Shkronjat “e”, “ë” dhe “n” të pikës 3, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“e) Me qëllim zbatimin efektiv të standardeve ndërkombëtare dhe evropiane, të adoptuara dhe bashkërendimin e projekteve në fushën e TIK-së, institucionet e mësipërme, në të gjitha rastet, marrin mendimin e AKSHI-t, për:

i) Specifikimet teknike të prokurimeve, të realizuara me fonde të Buxhetit të Shtetit, hua dhe/ose grante të dhëna nga donatorë;

ii) Procedurat që kanë lidhje me projektpropozime/projekte të ndryshme, dhurata apo ndihma materiale.

AKSHI jep mendimin e tij, brenda afatit prej 20 ditësh pune nga data e marrjes së dokumentacionit të sipërpërmendur.

“ë) Zhvillon, administron dhe mirëmban rrjetin qeveritar *GovNet* dhe portalin qeveritar;

.....

“n) Nëpërmjet Qendrës së të Dhënave Qeveritare (Datacenter Qeveritar) zhvillon dhe ofron shërbimet e infrastrukturës “*cloud*” për administratën publike. Qendra e të Dhënave Qeveritare ofron, minimalisht, këto shërbime të përqendruara elektronike:

i) Autentifikim dhe identifikim të sigurt;

ii) Postën elektronike qeveritare (*Gov mail*);

iii) Internet të sigurt;

iv) DNS të sigurt (*Domain Name System*);

v) Shërbimet Hosting për sisteme, pajisje, aplikime, faqe/portale *web* etj.”.

b) Pikat 3.1, 3.2 dhe 3.3 shfuqizohen.

2. Ngarkohen Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit dhe Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha